




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Junikut
Opština Junik - Municipality of Junik




KONTRATA

Titulli i tenderit: Ndërtimi i aneksit në objektin e Komunës / Punë shtesë

Numri i prokurimit: 636-20-3782-5-2-5

Numri i brendshëm: 636-19-015-521/5

Data: 07.09.2020



Komuna e Junikut (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), e përfaqësuar nga U.D. Zyrtaria Përgjegjëse e Prokurimit, Florinda Kukalaj në njërën anë, dhe

N.T.P Jeta (në vazhdim "Kontraktuesi"), me numër të regjistrimit të biznesit 810214320 dhe me numër fiskal 600043301, me adresë 51 050, Junik, me numër kontaktues: 044-178-669 dhe email: jeta.prishtine@gmail.com e përfaqësuar nga Rustem Krasniqi në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një ankes-kontrate publike për punët e shënuara me poshtë:

Numri i prokurimit	636	2	0	3	7	8	2	5	2	5
Numri i brendshëm	636		2	0	0	1	5	5	2	1/5

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës do të jetë Ndërtimi i aneksit në objektin e Komunës

PARAMASA DHE PARALLOGARIA					
Aneksi i objektit të Komunës/ Punë shtesë					
Nr.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmi./Nj me TVSH	Shuma totale me TVSH
1	Punët paraprake:				
1	Demontimi dhe largimi i murit pranë nyjes sanitare në kati I të objektit të Komunës në vendin ku bëhet lidhja me aneksin e ri, prerja e shtresës rrafshuse të betonit si dhe largimi i materialeve të betonit, stiroporit, llamarinës si dhe mbetjeve tjera deri në pllakën konstruktive në bazën e kulmit	copë	1.00	800.00	800.00
Totali i punëve paraprake					800.00
2	Punimet e betonit				
2	Betonimi i pllakës mbi nivelin e katit, për lidhjen e daljes emergjente të katit të dytë, me shkallët emergjente, në strukturën me parë të vendosur nga trajet e metalit dhe dyshemesë drasë, armimi rrjete Ø9/15cm, d=16.5cm. Në këtë pozicion hyjnë edhe arkitrarët e dritareve nga betoni i armuar sipas formave specifike ("qemer") të dhëna në projekt	m³	13.00	58.00	754.00
Totali i punëve të betonit					754.00

3	Punimet e armaturës				
3	Furnizimi, transporti, prerja, lakimi dhe lidhja e armaturës për shtylla, traje dhe pllakë Ø 8÷14mm, rrjeta Q-424 Mag 500/560	kg	600.00	1.00	600.00
	Totali i punëve të armaturës				600.00
4	Punimet e muratimit				
4	Furnizimi me material dhe punimi i mureve ndarëse sipas sistemit "Rigips" me trashësi total prej 12 cm (2,5 +7+2,5 cm), me izolim termik-lesh mineral, plaka rigipsi në të dy anët si dhe konstruksion mbajtës metalik me të gjitha detalet dhe punët përcjellëse të këtij sistemi të murit	m²	140.00	14.00	1,960.00
	Totali i punimeve të muratimit				1,960.00
6	Punimet e dysHEMEVE, mureve dhe pllafoneve				
6.1	Furnizimi me material dhe suvatimi i mureve të mbrendshme me POFIX (në thas) ose ekuivalent. Suvatimi të bëhet deri në rrafshim të plotë. Në çmim të parashihen edhe këndoret	m²	165.00	3.50	577.50
6.2	Furnizimi, transporti dhe gjetimi, paternimi me masë gleti në dy shtresa të mureve nga Knaufi	m²	165.00	2.00	330.00
6.3	Ngjyrosja e mureve dhe tavaneve të objektit ekzistues me ngjyrë qumshti. Në shtresën me parë të pregaditur, ngjyra e kualitetit të lartë me cilësi dhe standarde ekologjike që kërkohet për objektet administrative, rrezatim dhe radioaktivitet minimal	m²	550.00	1.00	550.00
	Totali i punimeve të dysHEMEVE, mureve dhe pllafoneve				1,457.50
7	Punimet finale				
7.1	WD-metal AL; vitrinat të cilat me dimensionet: lartësisë h=0.9m mbi mure ndarsë në lartësinë e tyre H=2.1m me ndriçim fiks, profil alumini ose plastike me dy goma për rreth ure termike xham termopan 2*6mm	m²	21.50	55.00	1,182.50
	Totali i punimeve finale				1,182.50

8	Instalimet elektrike, interneti, telefoni, televizioni dhe sistemi i alarmit për mbrojtje nga zjarri				
2	KABLOT FURNIZUESE				
2.2	Kabllo për qarqet për ndriçim PP-Y 3x1.5mm ²	m	450.00	1.30	585.00
2.3	Kabllo për qarqet për Priza PP-Y 3x2.5mm ²	m	280.00	1.50	420.00
2.4	Gyp plastik Æ 16 mm, për kabllo furnizues	m	450.00	0.30	135.00
	Gjithsej				1,140.00
4	Rrjeti i TEL. INT. DH TV.				
4.5	Kabllo IY (st) - Y 2x2x0.5mm ²	m	100.00	0.80	80.00
4.6	Kabllo UTP Cati 4x2x0.5 mm ²	m	100.00	0.80	80.00
4.7	Kabllo koaksiale për sinjal TV	m	40.00	1.00	40.00
4.8	Gypi i plastikës, Æ 11mm	m	200.00	0.35	70.00
	Gjithsej				270.00
5	SISTEMI I ALARMIT PËR MBROJTJE NGA ZJARRI				
5.4	Kabllo SASO 275-2x0.75mm	m	100.00	1.00	100.00
	Gjithsej				100.00
	Totali i Instalimeve elektrike, internetit, telefonit, televizionit dhe sistemit të alarmit për mbrojtjen nga zjarri				
10	Renovimi i dysHEMEVE të zyreve në objektin e Komunës së Junikut				

10.1	Gërryerja dhe largimi i tepihëve ekzistues të vendosur në sipërfaqet e dyshemeve në të gjitha zyret e objektit të komunës.	m ²	80.00	0.50	40.00
10.2	Furnizimi me material, sjellja e shtrirja në vend dhe punimi me <u>kontakt beton</u> i sipërfaqeve të dyshemeve të të gjitha hapësirave të destinuara për zyra në të gjithë objektin	m ²	80.00	0.30	24.00
10.3	Furnizimi me material, sjellja e montimi i dyshemesë së parketit cilësor nga druri i bungut për zyrat e kryetarit, nënkryetarit dhe parazyra . Në pozicion përfshihen komplet të gjitha punimet për punimin e shtresës së parketit si dhe këndoreve në perimetrit e hapësirave të zyreve	m ²	35.00	30.00	1,050.00
10.4	Furnizimi me material, sjellja e vendosja e <u>pllakave të qeramikës</u> në gjithë sipërfaqet e dyshemeve të zyrave në objekt. Në këtë pozicion përfshihet edhe punimi i fugës cilësore të pllakave të qeramikës. Për cilësinë dhe dizajnin e pllakave të qeramikës punëkryesi është i obliguar që të vendosë sipas rekomandimit të organit mbikqyrës	m ²	80.00	15.00	1,200.00
10.5	Furnizimi, sjellja dhe montimi i murit ndarës. Muri punohet me elemente konstruktive: profile metalike, shtresë izolimi në mes me trashësi 20 cm dhe mveshur nga të dy anët me gipsplakë	m ²	22.00	30.00	660.00
10.6	Furnizimi, sjellja dhe ngjyrosja e mureve të zyreve komunale me ngjyrë	m ²	120.00	1.50	180.00
	Totali i renovimit të dyshemeve të zyreve në objektin e Komunës së Junikut				3,154.00
11	Renovimi i kulmit të objektit të komunës				
11.1	Çmontimi dhe largimi komplet i këtyre materialeve të vjetra (tjegullat, listellat, kontra listellat dhe ullukët të llamarinës) nga e gjithë sipërfaqja e kulmit ekzistues. Materialet e larguara transportohen deri në vendin e paraparë për deponimin e inerteve të ngurta në konsultim me organin mbikqyrës	m ²	46.00	1.00	46.00
11.2	Furnizimi me material, sjellja e shtrirja në vend dhe përforcimi në sipërfaqen e tërë kulmit e folies difuzive cilësore për konstruksione të tilla siç është kulmi	m ¹	46.00	1.00	46.00
11.3	Furnizimi me material të ri , sjellja e vendosja (gozhdimi) e <u>kontralistelave</u> të materialit të drurit halor me dimensionet 5x2 cm në mënyrën siç ka qenë e vendosur më parë	m ¹	100.00	0.35	35.00
11.4	Furnizimi me material të ri , sjellja e vendosja (gozhdimi) e <u>listelave</u> të materialit të drurit halor me dimensionet 5x3 cm me hapin prej 40 cm. për vendosjen e tjegullave cilësore	m ²	220.00	0.35	77.00
11.5	Furnizimi me material, sjellja dhe vendosja e qeramidheve (tjegullave) dhe kulmarëve të materialit cilësor të argjilës për mbulimin e tërë sipërfaqes së kulmit të objektit të Komunës. Tjegullat dhe kulmarët duhet të kenë ngjyrën e kaftë. Hapi i vendosjes së rendeve të tjegullave duhet të jetë rreth 40 cm.	m ²	46.00	9.00	414.00
	Totali i renovimit të kulmit të objektit të komunës				618.00

REKAPITULLIMI		
1	Punët paraprake	800.00
2	Punimet e betonit	754.00
3	Punimet e armaturës	600.00
4	Punimet e muratimit	1,960.00
5	Punimet e kulmit	-
6	Punimet e dyshemeve, mureve dhe pllafoneve	1,457.50
6	Punimet finale	1,182.50
7	Instalimet elektrike, internet, telefoni, televizioni dhe sistemi i alarmit për mbrojtje nga zjarri	1,510.00

9	Punët e makinerisë	-
10	Renovimi i dysHEMEVE të zyreve në objektin e Komunës së Junikut	3,154.00
11	Renovimi i kulmit të objektit të komunës	618.00
	Shuma totale e punëve shtesë	12,036.00

1.1 Kontrata hynë në fuqi me 07.09.2020 dhe përfundon me 07.10.2020.

1.2 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.3 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë objekti i Komunës së Junikut.

1.4 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 12,036.00 €; Dymbëdhjetëmijë e tridhjetë e gjashtë euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimi të punëve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të kryej ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së punëve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Pejë- Dega në Deçan në pajtim me ligjin e Kosovës.



Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik- N.T.P "Jeta"

Për Autoritetin Kontraktues- Komuna Junik

Emri:	Rrustem Krasniqi	Emri:	Florinda Kukalaj
Pozita:	Drejtor	Pozita:	U.D. Zyrtare Përgjegjëse e Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	07.09.2020	Data:	07.09.2020
Vula:		Vula:	